REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – RËPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

GRUPI PUNUES PËR HARTIMIN E PROJEKT BUXHETIT TË KOMUNËS SË JUNIKUT PËR VITIN 2027-2029

Dëgjimi i tretë buxhetor
PROCESVERBAL

Data: 14.08.2026
Ora: 11:00
Vendi: Salla e Kuvendit Komunal, Junik

Të pranishëm:

- Z. Ruzhdi Shehu – Kryetari i Komunës
- Z. Besart Tofaj – Nënkryetar i Komunës
- Znj. Ardita Hoxha – Drejtore për Buxhet dhe Financa
- Z. Arten Hamza – Zyrtar kryesor financiar
- Përfaqësues të lagjeve dhe qytetarë të komunës

Pika e rendit të ditës:

- Prezantimi i Kornizës Buxhetore Komunale 2027–2029 sipas Qarkores së Parë Buxhetore.

Ecuria e takimit

Takimin e hapi Z. Arten Hamza, zyrtar kryesor financiar dhe njëherit kryesues i grupit punues i formuar me vendim të kryetarit të komunës, i cili përshëndeti të pranishmit dhe i falënderoi për pjesëmarrjen.
Z. Arten Hamza kërkoj nga te pranishmit qe te japin sa me shumë ide dhe propozime për Projektet Kapitale.

Më pas, Z. Hamza bëri prezantimin e Kornizës Buxhetore Komunale për periudhën 2027–2029, duke u fokusuar në burimet e financimit të komunës, ndryshimet krahasuar me vitin paraprak dhe planifikimin e shpenzimeve për vitet në vijim. Sa i përket procesit buxhetor sikurse edhe vitet e kaluara bazuar në LMFP secila organizatë buxhetore e nivelit lokal dhe qendror është e obliguar që të filloj me procesin e hartimit të dokumenteve strategjike ku një ndër to është edhe Korniza Afatmesme Buxhetore për vitet 2027-2029.

Buxheti i Komunës së Junikut përbëhet nga këto burime të financimit: granti i përgjithshëm, granti specifik i arsimit, granti specifik i shëndetësisë, të hyrat vetanake dhe donacionet.në dispozicion për vitin e ardhshëm.

- **Granti i përgjithshëm – 1,182,544.00 €**
- **Granti specifik i Arsimit – 647,214.00 €**
- **Granti specifik i shëndetësisë – 516,121.00 €**
- **Të hyrat vetanake – 193,595.00 €**

TOTALI – 2,539.474.00 €

Buxheti për Komunën e Junikut parashihet të jetë në shumë prej **2,539,474.00€** për vitin 2027.

- Grantet qeveritare: **2,345,879.00 euro**
- Të Hyrat Vetanake: **193,595.00euro**


Sipas Qarkores 2027/01 Grantet qeveritare në krahasim me vitin 2026 kanë ndryshim pozitiv në vlerë prej 2,568.00 euro apo e shprehur në përqindje 0.11% .


Ndryshimi është në Grantin e përgjithshëm në vlerë prej 0.0 apo 0.0%, Granti specifik për Arsim në vlerë prej -26,169.00 apo -3.89%, Granti specifik për Shëndetësi në vlerë prej 28,737.00 apo 5.90% krahasuar me vlerën e granteve të vitit 2026 .

Të hyrat vetanake kanë zvogëlim në vitin 2027 në krahasim me vitin 2026 në vlerë prej -1,706.00 apo -0.87% .

Burimet e financimit sipas viteve në Komunën e Junikut.

	Buxheti 2026	Buxheti 2027	Ndryshimi	%	Buxheti 2028	Ndryshimi	%	Buxheti 2029	Ndryshimi	%
Total Buxheti	2,538,612	2,539,474	862	0.03	2,564,757	25,283	1.00	2,687,717	122,960	4.79
THV	195,301	193,595	(1,706)	(0.87)	197,403	3,808	1.97	202,589	5,186	2.63
Grantet Qeveritare	2,343,311	2,345,879	2,568	0.11	2,367,354	21,475	0.92	2,485,128	2,485,128	4.97
Granti i përgjithshëm	1,182,544	1,182,544	-	-	1,169,119	(13,425)	(1.14)	1,250,946	1,250,947	7.00
Granti i arsimit	673,383	647,214	(26,169)	(3.89)	666,630	19,416	3.00	686,629	686,626	3.00
Granti i shëndetësisë	487,384	516,121	28,737	5.90	531,605	15,484	3.00	547,553	547,550	3.00







Planifikimi i shpenzimeve sipas viteve 2026 -2029

	2026	2027	2028	2029	2026/2027	2027/2028	2028/202
Paga dhe mëditje	1,898,712	1,957,674	1,978,357	2,083,317	3.11	1.06	5.3
Mallra dhe shërbime	313,500	261,400	263,000	268,000	-16.62	0.61	1.9
Shërbime komunale	54,900	63,400	63,400	66,400	15.48	0.00	4.7
Subvencione	70,000	70,000	70,000	70,000	0.00	0.00	0.0
Investimet	201,500	190,000	190,000	200,000	-5.71	0.00	5.2
Totali i buxhetit	2,538,612.00	2,542,474.00	2,564,757.00	2,687,717.00	0.15	0.88	4.7

Paraqitja grafike e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2027



Paraqitja grafike pjesëmarrja sipas kategorive ekonomike në vitin 2027



Pas prezantimit te Qarkores buxhetore fjala iu dha Kryetarit te Komunës për një fjale përshëndetëse për te pranishmit.

Kryetari Ruzhdi Shehu i përshëndeti te gjithë te pranishmit dhe i falënderoj për pjesëmarrje ne këto takime te rëndësishme dhe gjithashtu i inkurajoj te pranishmit qe te japin sa me shume ide dhe propozime te cilat do te shqyrtohen nga grupi punues dhe te jenë pjesë e dokumenteve strategjike zhvillimore te komunës se Junikut dhe po ashtu edhe pjese e buxhetit komunal për investime ne vazhdim.

Pas kësaj fjale përshëndetëse fjala iu dha te pranishmeve duke ju sqaruar se nëse dikush prej qytetarëve keni nevojë për sqarime rreth buxhetit apo procedurave të planifikimit të buxhetit, apo edhe propozime mund ti shprehni edhe me fjalë. Kërkesat e juaja do të merren parasysh dhe do shënohen ne procesverbal si dhe në raportin përfundimtar, dhe përgjigjet rreth atyre propozimeve mund ti merrni përmes dëgjimeve tjera publike apo edhe nga web faqja e komunës, prandaj ju kaloj fjalën juve që të shprehni propozimet e juaja.

Propozimet e paraqitura

Z. Arton Krasniqi, në emër të Lagjes Krasniqi:

1. Ndërtimi i shtëpisë për të moshuarit në komunën e Junikut.

Z. Avdyl Maloku :

1. Rregullimi i hapësirave afër Fushës Sportive ne lagjen Miroc – Malok si dhe parkun e lodrave po ne këtë lagje.

Z. Demokrat Ganijaj , kërkesë ne emër të Ali Ganijaj:

1. Ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit në fshatrat Gjocaj – Jasiq.

Z. Mehdi Kuçi:

1. Rregullimi i shtratit te Lumit Erenik, konkretisht ndriçimin publik në shëtitore për gjatë lumit Erenik.

Z. Zenun Shala : në emër të banoreve të Lagjes 7 Shtatori :

1. Funksionalizimi i kanalizimit te ujrave te zeza që derdhet në Travë – Ujërat e Zeza .

Mbyllja e takimit

Pas këtyre propozimeve nuk pati ndonjë propozim tjetër dhe u tha që propozimet e cekura në listën e propozimeve do ti shënojmë në procesverbal dhe raport të cilat do të publikohen në web faqe të Komunës së Junikut dhe do të shqyrtohen nga grupi punues për mundësin e përfshirjes së tyre në KAB-in Komunal dhe në planin buxhetor të Komunës së Junikut.

Pas kësaj moderatori Arten Hamza i falënderoj të gjitha për pjesëmarrje dhe mbylli takimin.

Në këtë takim morën pjesë gjithsej 15 qytetarë prej tyre 3 të gjinisë femërore.

Procesmbajtëse:

Rajmonda Krasniqi